



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 2504. prot

Dk 27.04.2020

URDHËR

Nr. 134, datë 27.04 2020

**“PËR
MIRATIMIN E FORMËS, MODALITETEVE DHE TË DHËNAVE QË PËRMBAN
RAPORTI STATISTIKOR I VEPRIMTARISË SË PËRMBARUESIT GJYQËSORË
PRIVATË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 60, pika 5, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor privat”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e përmbajtjes dhe formatit të raportit statistikor vjetor të veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privatë, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Dispozitat e këtij urdhëri janë të detyrueshme për të gjithë përmbaruesit gjyqësor privatë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë përmbarimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Raporti statistikor vjetor i veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat përmban të dhënat e mëposhtme:
 - a. Numrin e çështjeve përmbarimore të regjistruara në regjistrin e çështjeve përmbarimore;
 - b. Numrin e çështjeve të pushuara si të ekzekutuara terësisht, të pezulluara dhe aktive.
 - c. informacion në lidhje me administrimin e llogarisë bankare të veçantë.
4. Përmbaruesi gjyqësor privat është i detyruar të mbajë dhe plotësojë raportin statistikor vjetor me të dhënat e nevojshme, të përcaktuara në aneksin 1 bashkëlidhur këtij urdhri. Nëse një ose disa përmbarues gjyqësorë privatë organizohen në zyrë të përmbarimit privat, çdo përmbarues gjyqësor është i detyruar të mbajë dhe plotësojë raportin statistikor vjetor të veprimtarisë së tij.

5. Formati i raportit statistikor vjetor mbahet në formë elektronike. Formati elektronik konsiderohet programi Excel.
6. Përmbauesi gjyqësor privat përgatit dhe dërgon në rrugë elektronike në adresën e administruar nga struktura përgjegjëse për veprimtarinë e shërbimit përmbauesve gjyqësor privat në Ministrinë e Drejtësisë dhe njëkohësisht Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, raportin statistikor vjetor të veprimtarisë së tij, sipas formës së përcaktuar në pikën 5 të këtij urdhri dhe i plotësuar në mënyrë të rregullt, çdo vit brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.
7. Ngarkohen përmbauesit gjyqësor privat, strukturat përgjegjëse për veprimtarinë e shërbimit përmbauesve gjyqësor privat në Ministrinë e Drejtësisë, dhe Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësor Privatë për zbatimin e këtij urdhri.
8. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI



ETILDA GJONAJ (SALIU)



ANEKSI 1

RAPORTI STATISTIKOR VJETOR PËR VEPRIMTARINË E PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT

EMRI, MBIEMRI, VITI I RAPORTIT []

| LLOJI I TITULLIT EKZEKUTIV | Ceshtje ne Total | Ceshtje qe Kane Plotesuar Afatet Proceduriale | | | Ceshtje Brenda Afateve Proceduriale | | | Te Refuzuara | Te Pezulluara Vendim Gjyqate | Te Transferuara | Te Pushuara Neni 616/C | Vlera Ne Leke e Detyrimit | Llogaria bankare – Bilanci në mbajtjen e llogaritve të zvrës |
|-------------------------------|------------------|---|----------------|------------------------|---|----------------|------------------------|--------------|------------------------------|-----------------|------------------------|---------------------------|---|
| | | Ne Ekzekutim | Te Ekzekutuara | Te Pezulluara 615/D | Ne Ekzekutim | Te Ekzekutuara | Te Pezulluara 615/D | | | | | | |
| TOTALI | | | | | | | | | | | | | |